



Prishtinë, 27 qershor 2008

Kodi i ZRRE-së: D_103_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji duke u bazuar në:

1. Mandatin e tij ligjor të përcaktuar në Ligjin “Mbi Rregullatorin e Energjisë” të amendamentuar në ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e “Rregullës mbi Parimet e llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike (rregulla e çmimeve)” lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 15 dhjetor 2005;
3. Dispozitat e “Metodologjisë së tarifave për sektorin e energjisë elektrike”, lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 16 nëntor 2005;
4. Kërkesën e KOSTT-SH.A për Shqyrtimin e tarifave të transmisionit të datës 20 shkurt 2008.

Në seancën e bordit të mbajtur me datë 27 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat e transmisionit për t’u aplikuar nga KOSTT-SH.A, duke filluar nga 1 qershori 2008.
 1. Vendimi bazohet në dokumentet e lëshuara dhe të publikuara nga ZRRE-ja në faqen zyrtare elektronike të saj:
 - Rishikimi i Tarifave të energjisë elektrike 2008 – Raport Konsultativ, lëshuar më 10 mars 2008,
 - Rishikimi i Tarifave të energjisë elektrike 2008 – Përgjigje në komente, lëshuar më 15 prill 2008, dhe
 - Rishikimi i Tarifave të energjisë elektrike 2008 - Bashkërendimi i të hyrave të muajve maj dhe prill, lëshuar më 20 qershor 2008.



Tabela: Tarifatat e ngarkesës për KOSTT-SH.A që do të zbatohen nga data 1 qershor 2008

Grupi tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementet tarifore	Njësia	E aprovuar vitin 2008
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	0.000
		Tarifatat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifatat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	0.000
		Tarifatat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifatat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	0.000
		Tarifatat për operim të sistemit	€/MWh	0.289
		Tarifatat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	3.618
		Tarifatat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifatat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	7.878
		Tarifatat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifatat për operim të tregut	€/MWh	0.013

2. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Ky Vendim duhet të publikohet nga KOSTT-SH.A brenda 5 ditëve të punës pas njoftimit të ZRRE-së dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të saj, së paku në një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë.
4. Ky Vendim është nxjerrë në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar